



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RREGULLORE
“PËR MONITORIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE”

(Miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41 datë 12.03.2018)

Neni 1

Objekti

Objekti i rregullore është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, sipas dispozitave të Ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi i Monitorimit

AMA monitoron brezat e frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për transmetime audiovizive, me qëllim që:

- a. përdorimi i frekuencave të dhëna me licencë të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të licencës;
- b. spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- c. të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit audioviziv, që do të përdoren për qëllime private ose publike.
- d. të mbështesë procesin e administrimit të spektrit duke paraqitur tablo te qarte mbi shfrytëzimin e spektrit nga subjektet e licencuar/autorizuar nga AMA.

Neni 3

Baza ligjore

Dispozitat e kësaj rregulloreje hartohen në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.10 279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” si edhe të çdo akti tjetër nënligjor që nuk bie ndesh me parashikimet e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE-së për komunikimet elektronike, AVMSD-në, aktet e ITU-së dhe CEPT-it (Konferenca Evropiane e Postës dhe Telekomunikacioneve) në fuqi.

Neni 5 Monitorimi

1. Monitorimi i spektrit të frekuencave kryhet nga specialistet përkatës të Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe/ose nga nëpunës të tjerë, të specializuar, të administratës së AMA-s, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. Monitorimi kryhet kryesisht, ose me kërkesë të subjekteve të interesuara.
3. Monitorimi kryesisht kryhet në dy forma:
 - 3.1. **Monitorim në Distancë.** Monitorimi në distancë i brezave të frekuencave të përcaktuar për transmetime audio/audiovizive kryhet për rajonin Tiranë-Durrës, ku është përqendruar pjesa më e madhe e transmetuesve audiovizive dhe realizohet nga qendra fikse e monitorimit, që ndodhet në ambientet e AMA-s.
 - 3.2. **Monitorim në Terren.** Monitorimi në terren kryhet për të gjithë territorin e Shqipërisë, të paktën dy herë në vit. Monitorimi periodik realizohet nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit dhe pajisjeve të tjera në zonat dhe/ose ambientet ku subjektet audio/audiovizive ushtrojnë veprimtarinë audio dhe/ose audiovizive.
4. Monitorimi i spektrit të frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të subjekteve, të cilat zotërojnë një licencë të lëshuar nga AMA. Në këtë rast, shpenzimet e monitorimit përballohen nga subjekti i interesuar.
5. Si rregull, monitorimi kryhet pa praninë e përfaqësuesit të subjektit audio dhe/ose audioviziv të licencuar. Pavarësisht kësaj, për shkaqe të ndryshme, ose kur detyra e monitorimit nuk mund të përmbushet ndryshe, specialistët e përfshirë në monitorim kanë të drejtën të kërkojnë praninë e një përfaqësuesi dhe/ose që monitorimi të kryhet në ambientet ku subjekti ka të instaluar pajisjet transmetuese audio dhe/ose audiovizive. Në këtë rast, subjekti i licencuar nga AMA ka detyrimin që të vërë në dispozicion të specialistëve të përfshirë në monitorim një përfaqësues, si dhe të lejojë kryerjen e monitorimit në ambientet ku subjekti ka të instaluar pajisjet transmetuese audio dhe/ose audiovizive.

Neni 6 Procedura e Monitorimit

1. Monitorimi kryesisht.
 - a. Monitorimi në Distancë kryhet çdo ditë dhe, në ditën e fundit të punës të javës, aktet e monitorimit i dërgohen Drejtorit të Mbikëqyrjes dhe i përcillen, për dijeni, Kryetarit të AMA-s.
 - b. Monitorimi në terren kryhet në bazë të urdhrit përkatës të Kryetarit të AMA-s, në funksion të qëllimit të monitorimit, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj rregulloreje.
 - c. Për kryerjen e monitorimit në terren përdoret Qendra e Lëvizshme e Monitorimit të Spektrit të Frekuencave, si dhe çdo pajisje tjetër e disponoheshe nga AMA.

- d. Monitorimi në terren mund të kryhet në çdo kohë dhe në çdo ambient, pavarësisht nga kohëzgjatja normale e punës së specialistëve përkatës dhe/ose e përdoruesit të frekuencës që monitorohet.
 - e. Çdo pengesë për kryerjen e detyrës së monitorimit, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Monitorimi me kërkesë të subjekteve.
- a. Monitorimi i spektrit të frekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të subjekteve, të cilët zotërojnë një licencë të lëshuar nga AMA. Në këtë rast shpenzimet e monitorimit përballohen nga subjekti i interesuar.
 - b. Kërkesa e subjektit të interesuar duhet të jetë me shkrim dhe e argumentuar.
 - c. Me marrjen e kërkesës, Drejtoria e Mbikëqyrjes përgatit preventivin e shpenzimeve të monitorimit, i cili, pas vlerësimit nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe miratimit, sipas kompetencës, nga Kryetari, ose Sekretari i Përgjithshëm, i dërgohet subjektit të interesuar.
 - d. AMA bën monitorimin e frekuencave brenda tre ditëve nga kryerja e pagesës dhe del me konkluzionet përkatëse. Në rast se subjekti i interesuar nuk bën pagesën e shpenzimeve, brenda afatit të përcaktuar nga AMA, kërkesa i kthehet e pa trajtuar.

Neni 7

Detyrat e monitorimit

Detyrat kryesore të monitorimit, në përputhje me qëllimin e kësaj rregulloreje, me funksionet dhe detyrat kryesore të AMA-s, të përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013, janë:

1. Matja e përgjithshme e përdorimit të kanalit dhe brezave, përfshirë edhe verifikime të disponueshmërisë së frekuencave (shfrytëzimi i spektrit).
2. Verifikimi i zbatimit të kushteve të licencës nga subjektet audio dhe/ose audiovizive të licencuar, në lidhje (por duke mos u kufizuar vetëm) me:
 - a. Pikën transmetuese;
 - b. Frekuencën;
 - c. Mbulimin me sinjal;
 - d. Fuqinë nominale në dalje të transmetuesit;
 - e. Nivelin e sinjalit;
3. Matja e parametrave dhe karakteristikave teknike të sinjaleve bazuar në standardet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare (analizë sinjali):
 - a. Maskat;
 - b. Matje të modulimit/devijimet;
4. Dedektimi i interferencave elektromagnetike të spektrit.
5. Dedektimi dhe identifikimi i transmetimeve në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore;

Neni 8

Raporti i monitorimit

1. Në përfundim të çdo procesi monitorimi, përgatitet raporti i monitorimit, me përmbajtje si më poshtë:
 - a) përshkrim i qëllimit dhe monitorimit;
 - b) specialistët e përfshirë në monitorim;
 - c) data dhe koha gjatë së cilës është kryer monitorimi;

- d) pajisjet që janë përdorur për monitorimin;
 - e) rezultatet e monitorimit;
 - f) kushtet mjedisore të cilat mund të ndikojnë saktësinë e monitorimit;
 - g) konkluzionet dhe rekomandime për veprime të mëtejshme.
2. Raportit i bashkëngjiten kopje të akteve përkatëse të monitorimit dhe firmoset nga të gjithë specialistët e përfshirë në monitorim.
 3. Secili prej specialistëve të përfshirë në monitorim, kur nuk është dakord me raportin, ka të drejtë të shtojë vërejtjet e tij të arsyetuara për pika të veçanta apo për të gjithë raportin.

Neni 9

Baza e të dhënave

1. Sektori i Monitorimit dhe Arkivit krijon dhe mban të përditësuar bazën e të dhënave me informacion nga aktiviteti i monitorimeve të kryera.
2. Përmbajtja e bazës së të dhënave është kryesisht si më poshtë:
 - a) përshkrim i qëllimit dhe monitorimit;
 - b) specialistët e përfshirë në monitorim;
 - c) data dhe koha gjatë së cilës është kryer monitorimi;
 - d) pajisjet që janë përdorur për monitorimin;
 - e) vendi ku është kryer monitorimi;
 - f) subjektet audio dhe/ose audiovizive të monitoruar;
 - g) rezultatet e monitorimit;
 - h) masat e marra;
3. Drejtori i Drejtorisë Mbikëqyrjes paraqet pranë AMA-s çdo tre muaj relacion mbi konkluzionet e monitorimeve të kryera.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e monitoruesve

1. Specialistët e përfshirë në monitorim duhet të jenë të pajisur me dokument të posaçëm identifikues nga AMA, i cili përmban emrin/mbiemrin, fotografinë e tij, pozicionin e punës, datën e lëshimit, nënshkrimin e Kryetarit dhe vulën e institucionit.
2. Specialistët e përfshirë monitorim kanë të drejtë të fotografojnë pajisjet e transmetimit apo ambientet e subjekteve audio dhe/ose audiovizive për të dokumentuar procedurën, apo rezultatet e monitorimit.
3. Specialistët e përfshirë në monitorim gjatë kryerjes së procesit të monitorimit duhet të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ato të përdorimit të pajisjeve.
4. Ndalohet dalja në terren dhe kryerja e monitorimit në kushte të rënda atmosferike, veçanërisht në rastet e shkarkimeve atmosferike.

Neni 11

Te drejtat dhe detyrimet e subjekteve audio/audiovizive

1. Subjektet audio/audiovizive janë të detyruar të lejojnë personat përgjegjës të monitorimit, që sipas Urdhrit të Kryetarit të AMA-s, të kryejnë monitorimin në ambientet e transmetimit.

2. Subjektet audio dhe/ose audiovizive janë të detyruar t'i japin specialistëve të përfshirë në monitorim çdo informacion, të dhënë dhe/ose dokumentacion tjetër të nevojshëm në lidhje me procesin e monitorimit.

Neni 12

Kundërvajtjet administrative

Çdo përdorim i spektrit të frekuencave në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij, përfshi edhe këtë rregullore.

Neni 13

Procedura e Vlerësimit të matjeve

1. Kur gjatë ushtrimit të detyrave monitoruese, specialistët e AMA-s konstatojnë se përdorimi i frekuencave nuk është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe/ose në zbatim të kushteve të licencës, përgatisin relacionin e konstatimit.
2. Relacioni duhet të përmbajë informacion të hollësishëm për subjektin, datën, orën, frekuencën e monitoruar dhe shkeljen konkrete.
3. Relacioni, së bashku me çdo dokumentacion tjetër shoqërues, i kalon, sipas kompetencës, kryetarit dhe/ose sekretarit të përgjithshëm të AMA-s.
4. Pas vlerësimit të relacionit të konstatimit, si dhe materialit përkatës, kryetari dhe/ose sekretari i përgjithshëm i AMA-s, sipas kompetencës, autorizon vazhdimin e procedurës administrative dhe fillimin e hetimit administrativ.
5. Përdoruesi i frekuencës në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe/ose kushteve të licencës njoftohet sipas nenit 81 të ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në njoftim shënohet edhe afati brenda të cilit përdoruesi i frekuencës duhet të japë shpjegime, të dorëzojë çdo dokumentacion dhe/ose material që mund t'i kërkohej, si dhe të paraqesë pretendimet e tij me shkrim, të shoqëruara me provat përkatëse.
6. Në rast të mos respektimit të afatit të përcaktuar në njoftim, sipas pikës 5 të këtij neni, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i tij.
7. Parashikimet e këtij neni nuk e pengojnë AMA-n të kryejë një inspektim pranë përdoruesit të frekuencës, sipas Rregullores së Inspektimit, të miratuar nga AMA me vendimin nr. 101 datë 07.06.2017.
8. Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjit.

Neni 14

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar .
2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.